Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	**17.07.2023**	**26.07.2023**	**2023/0477**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.07.2023, OE "Sfinga SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0477, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. Liriu ; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Brig.123, 23000, SUHAREKË, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ekranat informues ne hyrje te Qytetit" me nr. të prokurimit: "OB614-23-5428-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 58,000.00 €. më Nr. 2023/0477 i dt:10.07.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 69 i LPP-së - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 29.05.2023, kurse data e fundit për dorëzim të tenderëve dhe hapja e ofertave ka qenë me dt. 09.06.2023. Kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Vlera e parashikuar e kontratës është 58,000.00 €.

Me dt. 20.06.2023 AK-ja ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku ka rekomanduar për kontrate GO ekonomik NSH "Liriu", NNSH "World Medium" me vlerën totale prej 49,130.00 euro, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues te pa suksesshëm me vlerën totale prej 49,526.00.

Pas qasjes ne dokumente qe kemi pasur, kemi vërejtur se AK-ja ka rekomanduar për kontrate GO ekonomik te pa përgjegjshëm te cilët nuk i plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe dosjes se tenderit.

Ne këto pretendime i kemi sqaruar ne kërkesën për rishqyrtim si ne vijim:

1.KATALOG për këto produkte. OE i rekomanduar për kontrate N.SH. Liriu , bazuar ne veprimtarin e deklaruar ne Info te Biznesit dhe ne kontratat e ofruara nuk është kompani prodhuese por është kompani SHERBYESE.

Andaj Katalogu ofruara ka te beje me SHERBIME e kurrsesi me produkte . PRODUKETET PER EKRANE DIGJITALE janë produkte qe prodhohen jashte Kosoves pra importohen.

Kjo do te thote se OE Liriu nuk ka ofruar KATLAOG TE PRODUKETVE - EKRAN DIGJITALE qe lidhen kerkesen ne dosje te tenderit.

AK OBILIQ ne FDt kerkon EKRANE DIGJITAKE ,m dhe nuk kerkon sjerbime per signalzim vertikale e horizontal.

2. Kontrata për Rimorkio Signalizuese eshte gjenerale dhe nuk ka te beje me DT te cilen e ka publiku AK Komuna e Obiliqit.

3. Lidhur me kërkesën për KONA, OE Liriu ka ofruar fatura nga kompania Donitrade por nuk ka ofrue dëshmi për transfer bankar qe lidhet me faturën.

4. OE LIRIU nuk ka ofruar asnjë kontrate qe dëshmon realizim te ekraneve digjitale LED te ciles do forme . qofte ne hyre e dalje nte qyteteve, , mbrenda tyre apo ne cilin do event.

Me dt.30.06.2023 kemi pranuar njoftimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK-ja me arsyetimin se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

AK-ja ka arsyetuar vendimin e saj si ne vijim:

	Pyetja e OE në kërkesën për Rishqyrtim:	Kërkesa sipas Dosjes së tenderit	Dëshmia e kërkuar sipas DT	SQARIMI nga AK
1	1. AK Komuna e Obilqit ne dosie te tenderit kerkon Ekrane Digitale respektivisht dhe KATALOG per keto produkte. OE i rekomanduar per kontrate N.SH. Liriu, bazuar ne veprimtarin e deklaruar ne Info te Biznesiv dhe ne kontratat e ofruara nuk eshte kompani prodhuese por eshte kompani SHERBYESE. Andaj Katalogu ofruarr ka te beje me SHERBIME e kursesi me produkte. PRODUKETET PER EKRANE DIGJITALE jane produkte qe prodhohen jahte Kosovës pra importohen. Kjo do te thote se OE Liriu nuk ka ofruar KATLAOG TE PRODUKETVE - EKRAN DIGITALE qe lidhen kerkesen ne dosje te tenderit.	Kerkesa nr.5. OE duhet të ofroj katallogun e produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.	Dëshmia nr.5. Katallogu duhet te jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.	Sa I perket QRB-së ne si AK nuk ken OE të jenë prodhues të Ekranave e regjistruar veprimtarinë e prodhimit OE I shpallur fitues, e ka dorëzuar kerkuar ne kerkesen 5 sipas dëshmisë në dosjen e tenderit.
2	2. Kontrata per Rimorkio Signalizuese eshte generale dhe nuk ka te beje me DT te cilen e ka publiku AK Komuna e Obilqit.	Kerkesa nr.4. OE me një listë duhet të paraqet pajisjet që ka në disponicion për realizimin e projektit: a).autokrep per ngritje në lartësi 2 cupë. b).kontrollues trafiku së paku 100 cupë. c) rimorkio me sinjalizues.	Dëshmia nr.4. Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal,ku duhet ti bashkëngjitim,fotografi ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit,ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontratë mbi qiramarrjen,per marrëveshjet e qirasë duhet ta dorëzoni marrëveshjet e noterizuara.	OE I shpallur fitues ka dorëzuar me qirasë për Rimorkio me sinjalizues,si ne DT.
3	Lidhur me kerkesen per KONA, OE Liriu ka ofruar faturn nga kompania Donitrade por nuk ka ofrue dëshmi per transfer bankar qe lidhet me faturen.	Kerkesa nr.4. OE me një listë duhet të paraqet pajisjet që ka në disponicion për realizimin e projektit: a).autokrep per ngritje në lartësi 2 cupë. b).kontrollues trafiku së paku 100 cupë. c) rimorkio me sinjalizues.	Dëshmia nr.4. Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal,ku duhet ti bashkëngjitim,fotografi ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit,ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose kontratë mbi qiramarrjen,per marrëveshjet e qirasë duhet ta dorëzoni marrëveshjet e noterizuara.	OE I shpallur fitues ka dorëzuar fatu me fotografi te konave,sipas kerkesës eshte kerkuar deshmi e transaksion
4	OE LIRIU nuk ka ofruar asnje kontrate qe deshmon realizim te ekraneve digitale LED te cilës do forme . qofte ne hyre e dalje te qyteteve, , mbeenda tyre apo ne cilin do event.	Kerkesa nr.1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, gjatë 3 (tri) viteve fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontratë) jo me pak se;45,000.00 €.Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar për funksione të ngjashme.	Dëshmia nr.1. Lista e kontratave të realizuara ku duhet saktësuar emërtimi e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten kontratat, referencat ose certifikatat për realizimin e projekteve të natyrës së ngjashme.	OE ka dorëzuar listen e punëve të ka punë të ngjashme me natyren e pro projekt si (Semafora,portale shenjezim,sinjalizim etj).Nuk eshte specifikisht të ketë referencën vetëm ndriques,por punë të ngjash

Ne lidhje me arsyetimet e AK-se deklarojmë se këto arsyetimi janë te pa bazuara dhe jo faktuara ne gjendjen reale dhe ne përputhje me kërkesat e FDT-së dhe dosjes se tenderit, e për te cilat do te japim sqarime si me poshtë: Ne lidhje me pretendimin e par e ku AK-ja është përgjigjur se : Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim e ka cekur se në lidhje me certifikatën e biznesit nuk është kërkuar që OE të jenë prodhues të ekraneve e as të kenë të regjistruar veprimtarinë e prodhimit të ekraneve, ndërsa ka shtuar se OE fitues e ka dorëzuar katalogun sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

1. Arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar për faktin se katalogu prezantohet nga një prodhues i cili i posedon produktet që gjenden në katalog. OE i rekomanduar për kontratë ka bërë një katalog në emër të kompanisë e cila nuk është prodhuese dhe nuk mund të bëj katalogun pasi që nuk i posedon produktet në pronësi të saj. I njëjti OE nuk ka prezantuar në ofertë as ndonjë autorizim nga prodhuesi i këtyre produkteve, me anë të së cilës do të dëshmohej se i njëjti do ta përmbush kontratën sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Kur kemi parasysh faktin se në Kosovë nuk ka ndonjë kompani e cila prodhon ekrane digjitale, atëherë është shumë i qartë fakti se OE i rekomanduar për kontratë është dashur të prezantoj ndonjë autorizim nga prodhuesi, e që një gjë të tillë nuk e ka bërë dhe si i tillë i njëjti është i papërgjegjshëm. Kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë shumë e qartë ku është kërkuar **"Kerkesa nr.5. OE duhet të ofroj katallogun e produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Dëshmia nr.5. Katallogu duhet te jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE"**. Pra në kërkesë është specifikuar saktë se duhet të ofrohet katalogu për produktet e kompanisë e që në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë nuk i posedon këto

produkte pasi që nuk është prodhues. Që produktet të cilësohen të kompanisë kompania duhet të jetë vetë prodhues, e që në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë jo vetëm që nuk është prodhues, mirëpo siç edhe e cekëm nuk është as kompani e autorizuar për shitjen e këtyre produkteve. Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë favorizimi që i është bërë OE të rekomanduar për kontratë nga ana e autoritetit kontraktues, pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i posedon produktet, nuk i prodhon ato dhe nuk është i autorizuar për shitjen e atyre produkteve nga prodhuesi. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së që të analizojnë në tërësi katalogun e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, pasi që i njëjti katalog nuk është i ndonjë prodhuesi të produkteve, mirëpo është i bërë nga një kompani e cila nuk është prodhuese e nuk është as e autorizuar për shitjen e këtyre produkteve. Sepse dihet që katalogu bëhet nga kompania prodhuese.

2. Kontata për Rimorkion Sinjalizuese nuk mund dhe nuk është dashur të merret parasysh nga ana e AK-së për faktin se kontrata nuk i përmban kushtet elementare për tu konsideruar kontratë valide. Kontrata është shumë e përgjithshme dhe nuk përmban as titullin dhe as numrin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk ka të bëj fare me këtë aktivitet të prokurimit, andaj arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar dhe njëkohësisht është vetëm favorizues për OE të rekomanduar për kontratë.

3. Në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket kërkesës në lidhje me KONAT, AK-ja e ka cekur se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar faturat dhe fotografitë e konave sipas kërkesës. Ju sqarojmë se ne nuk kemi parashtruar ndonjë pretendim ku e kemi cekur se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar faturat apo fotografitë, mirëpo ju sqarojmë se ne kemi pasur dhe kemi dyshime i njëjti nuk i posedon konat fare dhe dyshojmë në vërtetësinë e faturave të ofruara. Andaj përderisa i kemi dyshimet e tilla ne kërkojmë që të detyrohet OE i rekomanduar për kontratë të sjell edhe transaksionet bankare për blerjet e tilla, të cilat përkojnë me faturat e prezantuara.

4. Sa i përket pretendimit tjetër në lidhje me listën e kontratave të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, AK-ja e ka cekur se OE ka dorëzuar listën e kontratave të përfunduara të cilat janë të ngjashme me natyrën e këtij aktiviteti. Edhe përkundër faktit që nuk është kërkuar specifikisht që të prezantohen referenca vetëm për ekrane ndriçuese, ju sqarojmë se i njëjti OE në asnjërën nga kontratat e as në paramasën e atyre kontratave nuk ka ndonjë pozicion ku është përfunduar vendosja e ndonjë ekrani digjital. Për të përfunduar një aktivitet të tillë të prokurimit OE i rekomanduar për kontratë duhet të posedojë përvojën në përfundimin e ndonjë montimi të ndonjë ekrani digjital, e që në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përvojë të tillë fare. Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimet e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, andaj të njëjtat nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, pasi që pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë janë të qëndrueshme sepse i njëjti është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa AKja në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

5. Oe Sinjalzimi nuk ka ofrue fotot e kamionave me kran, edhpese kjo ka qene kerkese decidive

ne FDT.

Kerkesa nr.4. OE me një listë duhet të paraqet pajisjet që ka në dispozicion për realizimin e projektit; a).autokrop per ngritje në lartësi 2 copë. b).kona trafiku së paku 100 copë, c) rimorkio me sinjalizues.	**Dëshmia nr.4. Lista e paisjeve duhet të dorëzohet në origjinal,ku duhet ti bashkëngjiten,fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit,ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen,per marrveshjet e qirase duhet ta dorezoni marrveshjet e noterizuara.**

uke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE "SFINGA" SH.P.K. si e bazuar,

ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së, si dhe lënda te kthehet në

RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lënda / grupi: Ekranat informues në hyrje te Qytetit	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. " Liriu "; N.N.SH. WORLD MEDIUM,	49,130.00
2.	Sfinga SH.P.K., 810600280	49,526.00

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Ekranat informues në hyrje te Qytetit		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. " Liriu "; N.N.SH. WORLD MEDIUM	23000	Brig.123

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave ka konstatuar se në aktivitetin e prokurimit Ekranat informues në hyrje te Qytetit kanë ofertuar gjithsejtë dy(2) operatore ekonomik.

Operatoret Ekonomik " Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. " Liriu "; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Brig.123, 23000, SUHAREKË. ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike profesionale të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë. dhe eshte cmimi me I ulet I ofertes, ndersa :

Operatori Ekonomik Sfinga SH.P.K., Xhemë Gostivari nr.20/a, 20000, PRIZREN" I ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike profesionale të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontrate, , mirëpo për shkak të ofertës se tyre nuk janë ofertat e përgjegjshme me çmimin më të lire dhe nuk janë rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe në kriterin e dhënies se kontratës çmimi me i lire i ofertës se përgjegjshme ne si komision i vlerësimit rekomandojmë zyrtarin përgjegjës te prokurimit të shpërblej me dhënie të kontratës operatorin ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. " Liriu "; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Brig.123, 23000, SUHAREKË me vlerë të ofertës prej 49130.00€ dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Sfinga SH.P.K.**

Sqarim hyrës:Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Obiliq, **ka zhvilluar aktivitetin eprokurimit me titull:"Ekranat informues në hyrje te Qytetit", me numër të prokurimit: OB614-23-5428-1-2-1,procedurë e hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 58,000.00 €.**

Autoriteti Kontraktues ka publikuarNjoftimin për Kontratë me datën 29.05.2023, Ndërsa AK me datë 20.06.2023 ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.
Me datë 26.06.2023, OE-"SFINGA" SH.P.K., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kunder vendimit te AK-se.

Ndërsa, AK me datë 30.06.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 10.07.2023 OE-"SFINGA" SH.P.K., ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0477,dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

Pretendimi ankomor i OE ankues: "Pas qasjes ne dokumente qe kemi pasur, kemi vërejtur se AK-ja ka rekomanduar për kontrate GO ekonomik te pa përgjegjshëm te cilët nuk i plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe dosjes se tenderit. Ne këto pretendime i kemi sqaruar ne kërkesën për rishqyrtim si ne vijim:1.KATALOG për këto produkte. OE i rekomanduar për kontrate N.SH. Liriu , bazuar ne veprimtarin e deklaruar ne Info te Biznesit dhe ne kontratat e ofruara nuk është kompani prodhuese por është kompani SHERBYESE. Andaj Katalogu ofruara ka te beje me SHERBIME e kurrsesi me produkte . PRODUKETET PER EKRANE DIGJITALE janë produkte qe prodhohen jashte Kosoves pra importohen. Kjo do te thote se OE Liriu nuk ka ofruar KATLAOG TE PRODUKETVE - EKRAN DIGJITALE qe lidhen kerkesen ne dosje te tenderit".

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, sqaron se: *Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të*

dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmit), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, *ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë*:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:

Kerkesa nr.5. OE duhet të ofroj katallogun e produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia nr.5. Katallogu duhet te jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar në kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit, konsideroj se, sipas formulimit të kërkesës në dosjen e tenderit, katalloku i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe në njoftimit për kontratë, meqenëse AK në dosjen e tenderit ka kërkuar që **Operatorët Ekonomik të ofrojnë katallogun e produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt**, pa e specifikuar çështjen e prodhimit ose importimit të produkteve si dhe çështjen autorizimit nga prodhuesi për produktet e ofruara. Pra, përveç përshkrimit të lartëcekur, AK nuk ka kërkuar diqka tjeter specifike që katallogu duhet ti përmbaj. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pike është i pa bazuar.

Ky konstatim mbeshtetet në faktin se: **Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton:**

"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, **nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**".

Pretendimi ankomor i OE ankues: "2. Kontrata për Rimorkio Signalizuese eshte gjenerale dhe nuk ka te beje me DT te cilen e ka publiku AK Komuna e Obiliqit".

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, për Rimorkion me Sinjalizues, OE pretendon se Kontrata është shumë e përgjithshme dhe nuk përmban as titullin dhe as numrin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk ka të bëj fare me këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues sqaron se, në dosjen e tenderit nuk ka qenë kërkesë që kontrata të përmbaj titullin dhe as numrin e aktivitetit të prokurimit, por te dëshmia dokumentare në dosjen e tenderit kërkohet që "Dëshmia nr.4. Lista e paisjeve duhet të dorëzohet në origjinal,ku duhet ti bashkëngjiten,fotografit ku identifikohen pajisjet e

kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit,ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen,per marrveshjet e qirase duhet ta dorezoni marrveshjet e noterizuara", andaj kontrata për Rimorkion me Sinjalizues e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesën në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. **Andajky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.**

Pretendimi ankomor i OE ankues: "3. Lidhur me kërkesën për KONA, OE Liriu ka ofruar fatura nga kompania Donitrade por nuk ka ofrue dëshmi për transfer bankar qe lidhet me faturën".

<u>Përgjigje Pretendimit ankimor:</u>

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues,lidhur me kërkesën për KONA, ku thuhet se, OE Liriu ka ofruar fatura nga kompania Donitrade por nuk ka ofrue dëshmi për transfer bankar qe lidhet me faturën.

Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se, në dosjen e tenderit nuk ka qenë kërkesë që OE për kërkesën në fjalë të dëshmoj me trensfere bankare, por te dëshmia dokumentare në dosjen e tenderit kërkohet që "Dëshmia nr.4. Lista e paisjeve duhet të dorëzohet në origjinal,ku duhet ti bashkëngjiten,fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit,ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen,per marrveshjet e qirase duhet ta dorezoni marrveshjet e noterizuara", andaj fatura për KONAT e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesën në dosjen e tenderit dhe njoftim për kontratë. **Andajky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.**

Eksperti shqyrtues sqaron se, kurdo që AK dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar nga OE, sipas paragrafit 7 të nenit 52 të LPP-së, "**Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit**".

Pretendimi ankomor i OE ankues: "4. OE LIRIU nuk ka ofruar asnjë kontrate qe dëshmon realizim te ekraneve digjitale LED te ciles do forme . qofte ne hyre e dalje nte qyteteve, , mbrenda tyre apo ne cilin do event".

<u>Përgjigje Pretendimit ankimor:</u>

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, se "OE LIRIU nuk ka ofruar asnjë kontrate qe dëshmon realizim te ekraneve digjitale LED te ciles do forme . qofte ne hyre e

dalje te qyteteve, mbrenda tyre apo ne cilin do event".

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues sqaron se, *Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash,* në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmit), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, *ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë*:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:

Kerkesa nr.1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, gjatë 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;45,000.00 €.Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar për furnizime të ngjashme

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia nr.1. Lista e kontratave të realizuara ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten kontratat, referencat ose certifikatat për realizimin e projekteve të natyrës së ngjashme.

Eksperti shqyrtues sqaron se, sipas kërkeses së lartëcekur, AK ka kërkuar dëshmi se OE ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme dhe nuk ka kërkuar dëshmi se OE ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njejtë, Pra në rastin konkret, AK nuk ka kërkuar kontrata të natyrës së njejtë (Ekrana Informues). Andaj, Lista e Kontratave të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, i përgjigjet natyrës së kontratës dhe e plotëson kërkesen e dosjes së tenderit dhe qëllimit të kontratës, **rrjedhimishtky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.**

Pretendimi ankomor i OE ankues: 5. Oe Sinjalzimi nuk ka ofrue fotot e kamionave me kran, edhpese kjo ka qene kerkese decidive ne FDT.

Kerkesa nr.4. OE me një listë duhet të paraqet pajisjet që ka në dispozicion për realizimin e projektit; a).autokrop per ngritje në lartësi 2 copë. b).kona trafiku së paku 100 copë, c) rimorkio me sinjalizues.	**Dëshmia nr.4. Lista e paisjeve duhet të dorëzohet në origjinal,ku duhet ti bashkëngjiten,fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit,ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen,per marrveshjet e qirase duhet ta dorezoni marrveshjet e noterizuara.**

Eksperti shqyrtues sqaron se, këtë pretendim ankimor nuk e ka shqyrtuar fare, për faktin se, duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet ankimore ti parashtron pranë AK, e që në rastin konkret OE ankues, këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK-së në kërkesën për rishqyrtim, prandaj duke u bazuar në nenin 64 paragrafin 2 të Rregullores për Prokurimin Publik, e cila përcakton se: "Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". **Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues**", si dhe neni 13 paragrafi 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, e datës 03.03.2020 në të cilën thuhet se: "Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pra, sipas dispozitave të lartëcituar, pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues", andaj meqenëse ky pretendim ankimor nuk ka qenë në kerkesën për rishqyrtim pranë AK-së, si i tillë nuk është trajtuar nga eksperti shqyrtues për arsyet e cekura më lartë.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, andaj duke u bazuar në sqarimet e lartepermendura, kosideroj se, AK ka bërë vleresimin e tenderve në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së.

Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP, përcakton :

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Gjithashtu,

Autoriteti Kontraktues gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj:

" Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë..."

Po ashtu, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Sfinga SH.P.K.**

ismail rushiti